




# **MBI AKTIVITETIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT**

**KPP – Buletin periodik 12  
Korrik 2025**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR  
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,  
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN  
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

## Korrik 2025

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit gjatë muajit korrik ka zhvilluar mbledhje dhe tryeza konsultimi për hartimin e projektligjit për “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe të projektligjit për “Financimin e partive politike”.

### 4 korrik 2025

## Komisioni i Posaçëm miraton Planin Kombëtar të Veprimit

Nën drejtimin e kryetarit, z. Fatmir Xhafaj, u zhvillua mbledhja e radhës e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit. Në këtë mbledhje u miratua Plan i Kombëtar të Veprimit, që shënoi një tjetër hap të rëndësishëm në veprimtarinë e Komisionit.

Pas miratimit të procesverbaleve të mëparshme mbledhja vijoi me prezantimin e procesit dhe metodologjisë së punës për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit nga znj. Besarta Vladi, koordinatore e Sekretariatit Teknik të ngritur pranë Komisionit të Posaçëm. Znj. Vladi informoi mbi procesin gjithëpërfshirës e transparent të konsultimit publik dhe trajtimin e rreth 160 komenteve të ardhura nga aktorë të ndryshëm, si: institucionet publike, grupet e interesit, shoqëria civile, bota akademike, përfshirë edhe vlerësimet e komentet e ekspertëve vendas e ndërkombëtarë si dhe të grupit të negociatorëve të angazhuar me procesin e negociatave me BE-në etj.

Plani Kombëtar të Veprimit do të shërbejë për fuqizimin e kontributit dhe rolit aktiv të Kuvendit në forcimin e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimin e ligjit në përputhje me përcaktimet e bëra në rezolutën e Kuvendi, por dhe në procesin e negociatave. Dokumenti përcakton masa konkrete për rritjen e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e procesit të ligjvënies dhe monitorimin efektiv të procesit të integritetit.

Në mbyllje të mbledhjes z. Xhafaj bëri një përmbledhje të punës njëvjeçare të Komisionit, si dhe bëri të ditur se me vendimmarrjen e mëparshme për miratimin e dy grupeve të punës ka nisur procesi për hartimin e dy projektligjeve të rëndësishme në kuadër të masave antikorrupsion: projektligjit “Për konfliktin e interesit” dhe projektligjit “Për financimin e partive politike”. Këto projektligje do të hartohen nga grupe pune të ekspertëve të GENL-së dhe Sekretariatit Teknik, stafit të Kuvendit dhe ekspertë të angazhuar nga institucione të pavarura, si ILDKPKI-ja dhe KQZ-ja. Ky proces do të mbështetet edhe me asistencën e ekspertëve të Këshillit të Europës. Z. Xhafaj i vlerësoi këto iniciativa

edhe si pjesë të rëndësishme të përmbushjes së detyrimeve të Kuvendit në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian.

**23 korrik 2025**

## **Parandalimi i konfliktit të interesave, ekspertët mbledhen në Kuvend për tryezën e parë të konsultimit publik të draftit**

Ekspertë të GENL-së dhe të Sekretariatit Teknik të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar zhvilluan tryezën e parë të konsultimit publik për projektligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Ekspertët po mbështeten nga ekspertë të Këshillit të Europës.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga pushteti qendror, institucionet publike, organizata të shoqërisë civile, partnerët ndërkombëtarë dhe ekspertë të fushës.

Në fillim të mbledhjes kryetari i Komisionit të Posaçëm, z. Fatmir Xhafaj, e vlerësoi procesin si një hap të domosdoshëm për të përforcuar integritetin institucional dhe për të përmbushur detyrimet që vijnë nga procesi i integritetit europian.

Z. Xhafaj theksoi se është e rëndësishme që procesi të mos jetë thjesht formal apo i përsheptuar në mënyrë mekanike, por të jetë një proces ku të ndërthuren profilizimet e institucioneve dhe atyre që preken nga projektligji. Në përfundim z. Xhafaj vlerësoi mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare, veçanërisht të OSBE-së dhe të Këshillit të Europës, që kanë kontribuar në procesin e hartimit të ligjit.

Më pas prof. dr. Migena Leskoviku, përfaqësuese e GENL-së, bëri prezantimin e projektligjit të hartuar, për të cilin ekspertët i janë referuar propozimit të ILDKPI-së të vitit 2021, rekomandimeve të dhëna nga ekspertët e OSBE-së dhe të Këshillit të Europës, kuadrit ligjor në fuqi, rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare, rekomandimeve të dhëna nga BE-ja, KE-ja dhe GRECO si dhe praktikave më të mira në këtë fushë.

Në fillimi znj. Leskoviku bëri një prezantim të sugjerimeve të ardhura së fundi nga Komisioni Europian, të cilat do të reflektohen në vijim për efekt të përditësimit të draftit të parë. Znj. Leskoviku parashtroi se qëllimi primar i pasjes së një ligji të ri është thjeshtimi i detyrave të të gjithë zyrtarëve dhe institucioneve përgjegjëse, por edhe zvogëlimi i numrit të veprimeve që kërkojnë prej tyre për ta bërë ligjin e ri më të qartë, më të kuptueshëm, lehtësimi në zbatimin praktik të tij si dhe në

zgjidhjen e problematikave të hasura në zbatimin e kuadrit aktual ligjor.

Më pas znj. Leskoviku bëri një përmbledhje të parashikimeve të çdo kreu, duke nënvizuar se për formulimin e shumë ndërhyrjeve në legjislacionin aktual janë sugjerimet e ekspertëve të Këshillit të Europës.

Më pas z. Redi Ametllari - përfaqësues i IDM Albania, znj. Aranita Brahaj - eksperte AIS/Open Data Albania, z. Klajdi Karameta - zëvendësministër i Drejtësisë, znj. Juelda Lamçe - këshilltare ligjore e kabinetit në SPAK-ut, z. Besnik Dervishi - komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besfor Lamallari - zëvendësministër i Brendshëm, znj. Silvana Ramadani - këshilltare e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, z. Aldo Merkoçi - këshilltar i ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, znj. Violeta Lekaj - përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, znj. Agnes Behrnhard - drejtuese e projektit "JustAl" të BE-së, znj. Mirela Miti - eksperte e GENL-së, z. Vildan Plepi - përfaqësues i NDI-së, dhanë sugjerimet dhe bënë komente për përmirësimin e projektligjit dhe konkretisht për përfshirjen e subjekteve, qartësimin e ligjit dhe harmonizimin e tij me ligje të tjera, siç është ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të funksionarëve publikë etj.

Në përfundim të mbledhjes z. Xhafaj informoi për hapat e ardhëm të procesit pas reflektimit të të gjitha komenteve dhe sugjerimeve të pjesëmarrësve si dhe të ekspertit të Këshillit të Europës.

**23 korrik 2025**

## **Financimi i partive politike, ekspertët mbledhën për hartimin e një akti të ri ligjor**

Në kuadër të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, u zhvillua në Kuvend një tryezë konsultimi për kuadrin ligjor për financimin e partive politike. Ekspertë të nivelit të lartë të atashuar pranë Komisionit, përfaqësues të institucioneve publike, të organizatave të shoqërisë civile, të grupeve të interesit dhe të partnerëve ndërkombëtarë diskutuan për punën përgatitore për hartimin e një akti të ri ligjor për financimin e partive politike.

Kryetari i Komisionit të Posaçëm, z. Fatmir Xhafaj, tha se përgatitja e këtij akti është një nga çështjet që duhet trajtuar me shpejtësi për shkak të detyrimeve të procesit negociues të vendit për anëtarësim në Bashkimin Europian. "Janë të mirëpritura komentet tuaja. Natyrisht që mund të ketë dy lloje qasjesh dhe ne do të shohim cila do të jetë më e përshtatshme e cila do të prevalojë. Do të shohim nëse do të shkojmë

me një ligj të posaçëm për këtë çështje apo do të bëjmë amendim të legjislacionit ekzistues. Pasi të kemi zgjidhur këtë vendimmarrje, ne do të kalojmë në hartimin e aktit ligjor. Atëherë do të jeni bashkëpjesëmarrës në këtë proces konsultimi”, – tha z. Xhafaj në fjalën e tij.

Prof. Nadia Rusi në emër të grupit të ekspertëve tha se në këtë fazë paraprake do të merren sa më shumë sugjerime e komente nga të gjithë aktorët. Ajo bëri një paraqitje të legjislacionit aktual për çështjen e financimit të partive, duke iu referuar edhe praktikës së vendeve të tjera.

Gjatë diskutimeve pjesëmarrësit shprehën idetë e tyre dhe bënë sugjerime të ndryshme lidhur me amendime të mundshme të legjislacionit aktual.

Zoti Vildan Plepi, përfaqësues i Institutit Demokratik Amerikan, propozoi hartimin e një ligji të posaçëm për financimin e partive politike për t'i dhënë një rëndësi më të madhe kësaj fushe, bazuar dhe në praktikën e disa vendeve që kanë ligj të posaçëm.

Zoti Kristaq Kume, përfaqësues i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, mbështeti idenë e trajtimit të problemit të financimit të partive përmes një ligji të veçantë.

Zoti Afrim Krasniqi, përfaqësues i Institutit për Studime Politike, u shpreh se aktualisht gropa më e madhe informale në Shqipëri është financimi i partive politike. Ai propozoi legjislacionin italian si një model të mirë për t'u marrë shembull në këtë pikë. Zoti Krasniqi e vuri theksin të konsensusi politik, në mënyrë që ndërhyrja ligjore të jetë e qëndrueshme dhe efektive.

Znj.Valbona Kuko, drejtuese e Fondacionit Ëestminister për Demokraci, tha se asnjë nga partitë s'kanë struktura apo manual të menaxhimit financiar dhe se kjo është një çështje që duhet adresuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Robert Gajda, u shpreh se ligji aktual për partitë politike është i papërshtatshëm, pasi lë jashtë kandidatët e pavarur. Sipas tij, financimi i partive politike që konsiderohen të vogla, duhet të bëhet nga fondet publike për të garantuar një mbvshetje në garë. Po ashtu edhe mbështetja për subjektet e disavantazhura.

Znj. Arianita Brahaj, drejtoreshë e Open Data Albania, tha se modeli aktual i Kosovës ka dhënë rezultate dhe duhet marrë në konsideratë, por duke bërë korrigjime të nevojshme për vetë specifikat që ka vendi ynë për zgjidhjen e këtij shqetësimi. Ajo e vuri theksin te konsensusi i gjerë politik që kërkon ky proces dhe propozoi përfshirjen e të gjitha palëve.

Znj. Armela Krasniqi, kryetare e Autoritetit të Medieve Audiovizive, përmendi fushatat zgjedhore *on-line*, që sot zhvillohen kryesisht në rrjetet e kompanisë “Meta”, në *Tik Tok* etj. Ajo sugjeroi marrjen në konsideratë të ligjit europian për lirinë e medias, ku flitet edhe për reklamën politike si dhe ligjit për shërbimet dixhitale. Sipas saj, kryqëzimi i këtyre instrumenteve ligjore të miratuara nga Parlamenti Europian jo vetëm do të ndikojë në marrjen e një informacioni shumë të mirë, por i detyron platformat e mëdha të shpërndarjes së videove që t’i përgjigjen shtetit shqiptar me transparencë të detajuar se sa para janë harxhuar nga secili individ në këto platforma.

Znj. Licela Veliu, përfaqësuese e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sygjeroi që për shkak të numrit të madh të partive politike që duhet të auditohen dhe për të shmangur një proces shumë burokratik të vendosen prioritetet e ndoshta të auditohen ato parti që kanë përfituar fonde publike.

Në fund të takimit kryetari i Komisionit të Posaçëm, z. Fatmir Xhafaj, theksoi se ende nuk ka një projekt paraprak. “Ne duam të bëjmë një kornizë, një dokument politik se si do t’i qasemi. Ne kemi parashikuar nevojën për të pasur ndryshim ose një ligj të ri për partitë politike. Kjo është dhe në Planin Kombëtar të Veprimit. Tani është në vullnetin e ligjvënësit në shtator se si do të vendosë. Ne bëjmë një hap të parë, i cili nuk do të ishte shumë i shëndetshëm nëse nuk do të bënim këtë diskutim me ju sot. Konsensusi më i mirë është korniza e BE-së dhe certifikimi që do t’i bëjë Bashkimi Europian”, – tha z. Xhafaj.

**24 korrik 2025**

## **Takimi përmbyllës me gazetarët. Kryetari i Komisionit të Posaçëm: “Dokumenti Analitik dhe Plani Kombëtar i Veprimit janë dorëzuar në Kuvend. Komisioni e përmbushi qëllimin”**

Kryetari i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, z. Fatmir Xhafaj, doli në një konferencë për mediet për të njoftuar përfundimin e veprimtarisë së Komisionit si dhe për të bërë një bilanc të punës së realizuar deri më tani. Zoti Xhafaj kujtoi se filloi drejtimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar me një bashkëbisedim me gazetarët për të bërë publike qëllimin e ngritjes së Komisionit dhe në fund të mandatit ndien detyrimin për ta mbyllur po me një bashkëbisedim me gazetarët, kjo në funksion të transparencës me ta dhe me qytetarët. Zoti Xhafaj theksoi se Komisioni i Posaçëm e përmbushi qëllimin për të cilin u ngrit, ndonëse pati një mandat të kufizuar me vetëm 14 muaj dhe me periudhën elektorale në mes.

“Komisioni me dokumentet e hartuara dhe të miratuara zgjidhi një sërë problematikash dhe vendosi piketa të qarta, aq të domosdoshme, për përballjen me tri sfidat kryesore të zhvillimit: mirëqëverisjen, luftën kundër korrupsionit dhe sundimin e ligjit, që janë thelbësore për konsolidimin e shtetit të së drejtës. Nga ana tjetër, përmes këtyre dokumentave qartësoi përgjegjësitë për një rol më aktiv të Kuvendit në procesin e negociatave për Shqipërinë 2030 në BE dhe reformimin e vetë Kuvendit, nisur kjo edhe nga konteksti i zhvillimeve të integritetit evropian të Shqipërisë dhe reflektimet ligjore dhe institucionale me sfidat në kuadër të këtij procesi”, – tha Xhafaj, i cili më tej theksoi se metodologjia e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm është një ndër më të plotat dhe më të qartat për të garantuar transparencën, gjithëpërfshirjen dhe profesionalizmin. Ai tha se këtë përvojë të krijuar, këtë model tashmë të realizuar Kuvendi mund t’a aplikojë në të gjitha proceset e tjera të ngjashme, në përmbushje edhe të rekomandimeve të vazhdueshme për këtë aspekt në raportet e KE-së. “Gjithë ky proces i ndërtuar është mbështetur dhe ka garantuar 4 parime themelore, që janë: gjithëpërfshirja, transparenca, profesionalizmi dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Synimi kryesor i Komisionit të Posaçëm ka qënë – dhe besoj se ia kemi arritur përmes metodologjisë së zbatuar – që i gjithë ky proces në vetvete e veçanërisht dokumentet që janë hartuar së bashku me propozimet përkatëse të garantojnë standarte europiane, reflektimin e praktikave më të mira të vendeve të BE-së, të jenë në përputhje të plotë me rekomandimet e BE-së dhe me kriteret për pozicionet negociuese”, – tha Xhafaj.

Duke folur për impaktin e punës së bërë në Komisionin e Posaçëm nga rreth 119 ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ai përmendi disa nga arritjet që i çmon si vlera dhe risi të këtij procesi kompleks:

“1. Për herë të dytë në këta 10 vjet Kuvendi i Shqipërisë u shndërrua në hapësirën kushtetuese e institucionale për realizimin e një tjetër reforme shtetndërtuese, që synon konsolidimin e shtetit të së drejtës, por që i shërben edhe procesit të anëtarësimit për Shqipërinë 2030 në BE. Vështirë të gjeni një shembull të dytë në rajon e më gjerë të ndërmarrjes me iniciativë nga vende kandidatë për në BE të projekteve të tilla kaq komplekse, përfshirëse dhe me ambicien e fortë për ndryshim.

2. Përfshirje e gjerë e të gjithë faktorëve kryesorë të shoqërisë. Kjo e bën këtë një projekt kompleks për nga koordinimi dhe realizimi, por që përbën njëherësh edhe një model se si duhet të ndërtohen reforma të tilla, duke shkuar nga analiza e situatës tek identifikimi i gjetjeve dhe përcaktimi i masave për zgjidhje, te procesi ligjvënës dhe pastaj te zbatimi dhe monitorimi.

3. Ky proces ishte një kontribut tjetër me vlerë edhe në një aspekt tjetër me rëndësi lidhur me integritetin dhe imazhin e vendit. Një dëshmi e

rritjes së vendit, e institucioneve të tij edhe në një këndvështrim tjetër, duke provuar se tashmë ne kemi kapacitetet për të ndërmarrë hapa që vende të ngjashme me ne nuk kanë pasur kurajën t'i ndërmarrin.

4. Ne hartuam dhe miratuam një analizë, një Dokument Analitik prej rreth 700 faqesh, i pari dokument i këtij lloji që mban autorësinë e ekspertizës shqiptare. Analiza bën një skanim të situatës aktuale në tri fushat mbështetur në raportet përkatëse zyrtare të viteve të fundit, vendase dhe ndërkombëtare dhe kryesisht në gjetjet, vlerësimet, problematikat dhe rekomandimet e raporteve të BE-së dhe dokumentave ku shteti shqiptar ka shprehur angazhimet e tij në kuadër të procesit të integritetit.

5. Plani Kombëtar i Veprimit përbën një tjetër vlerë dhe risi të këtij procesi. Ai është një dokument unik i këtij lloji në veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë gjatë këtyre dekadave të demokracisë parlamentare në vendin tonë.

6. Ky proces nuk mund të konsiderohej i plotë pa realizimin e një procesi intensiv të konsultimit publik për të gjitha fazat e hartimit të dy dokumenteve”, – tha Xhafaj teksa përmendi 11 tryeza debati dhe diskutimi, 8 forume dialogu qytetar, 2 konferenca të nivelit të lartë për prezantimin e Analizës dhe Planit Kombëtar të Veprimit etj.

Gjatë këtyre 14 muajve, tha më tej Xhafaj, Komisioni ka përmbyllur dy fazat e para të tij dhe i ka dorëzuar Kuvendit dy dokumente parlamentare bazë: Dokumenti Analitik dhe Plani Kombëtar i Veprimit. Ai shpjegoi përmbajtjen e këtyre dokumenteve.

“Dokumenti Analitik për të tria fushat: *mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit*, është një dokument me 709 faqe dhe trajton të gjitha aspektet në 18 kapituj. Struktura e analizës është e organizuar në mënyrë të tillë që për çdo çështje të ofrohet një pasqyrë e situatës aktuale, duke shqyrtuar masat ligjore dhe institucionale të zbatuara. Për përgatitjen e kësaj analize ekspertët e nivelit të lartë kanë skanuar dhe analizuar mbi 15.000 faqe dokumentash, analiza e raporte të ndryshme. Plani Kombëtar i Veprimit është një dokument që përcakton masa konkrete, horizontale dhe sektoriale, të cilat synojnë përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiive të Kuvendit, në kuadër të procesit të negociatave të antarësimit të Shqipërisë në BE. Plani Kombëtar i Veprimit përmban 56 fusha tematike, të cilat trajtojnë çështjet kryesore me 245 masa konkrete, nga të cilat 71 janë nisma ligjore dhe 174 masa institucionale. Këto janë dy dokumente të rëndësishme parlamentare, produkt i punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Ndërkohë kemi hapur rrugën edhe për zbatimin e masave ligjore dhe institucionale të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit. Ashtu siç bëmë jo më larg se dje në diskutimin dhe konsultimin publik të dy projektligjeve, si

masa institucionale të propozuara në Planin Kombëtar të Veprimit të shtyllës “Antikorrupsioni” dhe siç do të bëjmë me procesin që pason. Dokumenti Analitik dhe Plani Kombëtar i Veprimit, të miratuar e të publikuar në fagen e Komisionit, përbëjnë dokumente parlamentare me rëndësi dhe janë pjesë e përgjegjësisë dhe angazhimit të strukturave të Kuvendit në fushat respektive”, – tha Xhafaj.

Sa i përket së ardhmes së veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm, Fatmir Xhafaj tha se, bazuar edhe në diskutimet e deritanishme, mbështetur në rezolutën e Kuvendit, por edhe në masat e propozuara në Planin Kombëtar të Veprimit, është e nevojshme që një komision ose një nënkomision parlamentar i përhershëm ose një strukturë në nivel institucional, si të gjykohet nga Kuvendi,

“Kjo për të vijuar me fazën e tretë të hartimit dhe miratimit të projektligjeve të identifikuara si masa nga Plani Kombëtar i Veprimit, si pjesë e listës prioritare të ligjeve, ashtu si dhe me vijimin e punës për realizimin e detyrës për kapitullin “III. 3: Konsolidimi i reformës në drejtësi”. Dokumenti analitik e veçanërisht Plani Kombëtar i Veprimit bashkëngjitur janë dokumente parlamentare me vlera të shumanshme, efekti shumë pozitiv i të cilave do të përcaktohet nga shkalla e angazhimit për zbatimin e tij nga Kuvendi dhe strukturat e tij në legjislaturën e ardhshme 2025–2029 në funksion të ambicies sonë legjitime: Shqipëria 2030 në BE”, – tha Xhafaj.

Në përfundim ai falënderoi kolegët deputetë pjesëmarrës në Komisionin e Posaçëm, Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Sekretariatit Teknik, stafin e Kuvendit dhe të gjithë aktorët që morën pjesë aktivisht në proceset e konsultimit dhe diskutimit, vendas dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të institucioneve publike, të institucioneve të pavarura, të shoqërisë civile, botës akademike, komunitetit të biznesit, qytetarët e angazhuar në këtë proces e natyrisht gazetarët e lirë të medias, që kanë përcjellë mbledhjet dhe janë përpjekur të pasqyrojnë me realizëm punën e bërë nga Komisioni i Posaçëm.

## **Komisioni i Posaçëm Parlamentar**



## **KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,  
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR  
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**